



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORE
ZYRA PROTOKOLL-ARKIVËS
Nr. 82/23 Prot.
Datë: 6.01.2020

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më 09.01.2020

VENDIM

Nr. 23, datë 9.01.2020

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
"BACHELOR" NË "DREJTËSI"**

Mbështetur në shkronjën d të pikës 1 në nenin 38 në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", shkronjën dh të pikës 1 në nenin 19 në Statutin e UV-së, Senati Akademik në mbledhjen e datës 9.01.2020

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Drejtësi" (bashkëlidhur).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË
CIKLIT TË PARË
"BACHELOR" NË "DREJTËSI"

Neni 1

Baza Ligjore

Kjo rregullore është hartuar në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutit dhe Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës.

Neni 2

Emërtimi dhe statusi i programit

Programi mësimor **Bachelor në Drejtësi** është program i studimeve të ciklit të parë, i ofruar nga Departamenti i të Drejtësisë, Fakulteti i Shkencave Humane në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë.

Neni 3

Gjuha e përdorur

Gjuha e përdorur për zhvillimin e programit të studimeve Bachelor në Drejtësi është gjuha shqipe. Në rastet e zbatimit të programeve Erasmus, Departamenti i Drejtësisë ofron mësimëdhënien në një nga pesë gjuhët e huaja të parashikuara në Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Vlorës.

Neni 4

Objektivat formuese të programit të studimit Bachelor në Drejtësi

Programi mësimor 'Bachelor në Drejtësi' formon juristë të cilët mund të konkurrojnë për t'u përgatitur si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, noterë, avokatë të shtetit, përmbarues privatë ose shtetërorë, si dhe juristë në administratën shtetërore, qendrore dhe vendore.

Objektivat e këtij programi përfshijnë:

- Fitimin e njohurive të thelluara në disiplinat juridike.
- Plane bashkëkohore të asistencës ligjore në institucionet publike që operojnë në sektorin publik, si dhe në sektorin privat;
- Të menduarit kritik në gjykimet dhe vendimmarrjet profesionale;
- Komunikimin efektiv dhe etikën profesionale;
- Kontribuimin në rritjen e kapaciteteve të specialistëve në fushën e drejtësisë;
- Thellimin e aftësisë për të punuar në grup duke shfaqur një shkallë të lartë autonomie dhe përgjegjësie, personale dhe profesionale, në koordinim edhe me operatorët e tjerë profesionalë ndërveprues.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË SENATI AKADEMIK

Gjatë gjithë periudhës së formimit studentit do t'i duhet të zhvillojë aftësitë e nevojshme për të kontribuar në zgjidhjen e çështjeve me karakter ligjor, social, politik dhe ekonomik me qëllim realizimin e një shërbimi cilësor në administratën publike, sektorin privat si dhe organizatat ndërkombëtare apo rajonale.

Neni 5

Organizimi i studimeve

Ky program mësimor është i organizuar në tre vite akademike (6 semestra) dhe në përfundim të tij studentët grumbullojnë 180 Kredite (ECTS) dhe marrin diplomën: Bachelor në Drejtësi.

Neni 6

Plani mësimor

1. Plani mësimor i Bachelor në Drejtësi është dokumenti themelor i programit të studimit, në të cilën shprehet veprimtaria formuese e studimit. Plani përfshin elementët kryesorë me karakter të gjerë informativ, të cilët parashtrohen në mënyrë të sintetizuar sa më poshtë vijon:

- Emërtimin e programit të studimit, objektivat formuese, kohëzgjatja normale e studimeve.
- Tërësia e veprimtarive formuese (disiplinave) që përbëjnë programin e studimit, të grupuara nëpër semestra dhe të renditura sipas semestrave.
- Kreditet për çdo veprimtari formuese, shpërndarjen e krediteve brenda një disipline sipas aktiviteteve formuese të saj (leksion, seminare, detyra, projekte, etj), ngarkesa në auditor, ngarkesa javore në auditor.
- Karakteristikat e tezës së diplomës.

2. Plani mësimor është objekt rishikimi dhe vlerësimi periodik sipas paashikimeve të Statutit dhe Rregullores së Universitetit të Vlorës

Neni 7

Format dhe organizimi i studimit të programit Bachelor në Drejtësi

Në programin mësimor Bachelor në Drejtësi veprimtaritë formuese që karakterizojnë programin e studimit ndahen në mësim në auditor (leksione, seminare,) studim individual (studim, praktikë gjyqësore, detyra kursi, projekte, provime, temë diplome etj.), në bazë të Ligjit për Arsimin e Lartë në Fuqi, Statutin, Rregulloren e Universitetit të Vlorës dhe aktet nënligjore në fuqi:

Leksionet dhe seminarët zhvillohen në ambientet e Universitetit 'Ismail Qemali' Vlorë në përputhje me orarin e parashikuar në fillim të semestrit.

Neni 8

Kurrikulat e ofruara për studentët

Kurrikulat e moduleve të ofruara për studentët nga Departamenti i Drejtësisë janë paraqitur në syllabyset përkatëse të çdo lënde, dhe shpallen në fillim të semestrit nga pedagogu përkatës.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

Programi i plotë i kurrikulave mësimore të ofruara për studentët e Departamentit të Drejtësisë për programin Bachelor në Drejtësi mund të tërhiqet tek Sekretaria e Departamentit të Drejtësisë, pas pagesës përkatëse.

Neni 9

Detyrimet që lidhen me frekuentimin

- Frekuentimi i leksioneve parashikohet në syllabusin e çdo lënde në përputhje me përcaktimet e bëra në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Vlorës.
- Frekuentimi i seminareve parashikohet në syllabusin e çdo lënde në përputhje me përcaktimet e bëra në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Vlorës.

Neni 10

Kreditet dhe detyrimet penguese për çdo disiplinë apo veprimtari tjetër formuese

Studenti që ndjek programin mësimor Bachelor në Drejtësi:

- mund të regjistrohet në lëndët me kode DRE 2.. vetëm pasi të ketë marrë paraprakisht 30 ECTS në këtë program studimi.
- mund të regjistrohet në lëndët me kode DRE 3.. vetëm pasi të ketë marrë paraprakisht 80 ECTS në këtë program studimi.

Neni 11

Format e kontrollit të dijeve

Programi mësimor Bachelor në Drejtësi parashikon në total 22 vlerësime përfundimtare të dijeve, duke përfshirë vlerësimet përfundimtare të lëndëve mësimore, të praktikës profesionale sipas parashikimeve të Statutit dhe Rregulloreve të Universitetit të Vlorës:

Format e kontrollit të dijeve përfshijnë vlerësimin vjetor, detyrat e kursit, projektet, provimet, praktika dhe temat e diplomave.

Kreditet korresponduese për çdo veprimtari formuese fitohen nga studentët vetëm për vlerësim pozitiv në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tyre. Për verifikimin e dijeve përdoren forma të ndryshme që kombinojnë verifikimin e vazhdueshëm (angazhimi në seminare dhe projektet/detyrat e kursit) me provimin përfundimtar.

Kontrolli i dijes së një lënde (provimi) përcaktohet nga titullari/ lektori i lëndës dhe mund të bëhet:

- a) me shkrim,
- b) me gojë,
- c) i kombinuar, me shkrim dhe me gojë

duke u mbështetur në programin mësimor të lëndës.

Tezat e provimit, në të gjitha rastet e kontrollit, hartohen nga titullari/lektori i lëndës.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

Në përfundim të programit të studimit, studentit i njehsohet Nota Mesatare e Ponderuar, që merr në konsideratë edhe kreditet respektive për çdo disiplinë apo veprimtari tjetër formuese.

Neni 12

Kushtet për t'u konsideruar kalues në një lëndë

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10. Notat nga pesë e lartë janë kaluese.

Në format e kontrollit me shkrim (provime, detyra/projekte kursi) përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimit, konvertohet në notë. Në vlerësimin final të lëndës pedagogu përkatës përcakton edhe peshën e vlerësimit të punës së pavarur të studentit (detyrave/projekteve të kursit).

Normat e konvertimit në notë të pikëve të grumbulluara përcaktohen nga pedagogët përkatës në çdo syllabus.

Neni 13

Procedurat e testimit dhe apelimit të rezultateve të testimit nga ana e studentëve

Procedura e kontrollit të dijeve është si më poshtë:

1. Në bazë të rregullores së UV, kontrolli i njohurive në programet mësimore të Fakultetit të Shkencave Humane bëhet me një provim final dhe me detyrën e kursit.
2. Brenda 48 orësh nga kontrolli i njohurive (me gojë ose me shkrim) pedagogu njofton studentët për rezultatin e vlerësimit në provim.
3. Studenti ka të drejtë të shikojë fletën e tij të provimit individualisht.
4. N.q.s është i paqartë ose nuk është dakord me vlerësimin që ka marrë, ka të drejtë të kërkojë sqarime nga pedagogu përkatës.
5. N.q.s studenti është i paqartë ose nuk bindet për rezultatin e provimit paraqet një kërkesë me shkrim pranë sekretarisë së departamentit.
6. Në bazë të kësaj kërkesë departamenti ngre një komision apelimi *ad hoc* për vlerësimin e kërkesës së studentit. Komisioni duhet të bëjë rivlerësimin e provimit të studentit dhe duhet të japë përgjigje brenda tre ditëve nga momenti i paraqitjes së kërkesës për rivlerësim.
7. Pikët përfundimtare të testimit janë ato të vendosura nga komisioni i apelimit.

Neni 14

Rikontrollimi i dijeve të fituara

Studentët që kanë ndërprerë përkohësisht studimet duhet t'u nënshtrohen kontroleve për verifikimin dhe vlerësimin periodik të krediteve të fituara, në përputhje me programet mësimore.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

Neni 15

Orari mësimor

Koha dhe auditori i zhvillimit të mësimit përcaktohet në orarin e shpallur nga Departamenti i Drejtësisë. Orari duhet të respektohet plotësisht nga të gjithë studentët dhe mësimdhënësit e Universitetit. Kohëzgjatja mësimore është 50 minuta dhe parashikohet në orarin mësimor.

Orari i përgjithshëm i Departamentit të Drejtësisë duhet të shpallet përpara fillimit të semestrit. Orari i provimeve finale duhet të shpallet përpara fillimit të sezonit të provimeve.

Orari hartohet nga Departamenti i Drejtësisë dhe miratohet nga zëvendës-dekani i Fakultetit të Shkencave Humane dhe zëvendës-rektori akademik i UV.

Neni 16

Karakteristikat e Detyrave/Projekteve të kursit

Detyrat dhe projektet e kursit në programin Bachelor në Drejtësi mund të jenë dy lloje: kazuse dhe detyra kursi.

Kazuset i referohen analizimit të çështjeve praktike gjyqësore të bazuara në jurisprudencën kombëtare dhe ndërkombëtare të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë si dhe gjykatave të tjera.

Detyrat e kursit duhet të jenë punime individuale ose në grupe të studentëve sipas përcaktimeve të bëra nga pedagogu i lëndës, në përputhje me syllabusin e lëndës.

Neni 17

Të drejtat dhe detyrimet e studentëve

Studentët e Departamentit të Drejtësisë në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë kanë të drejtë:

- të ndjekin të gjitha veprimtaritë mësimore, që zhvillohen në kuadrin e programit të studimit ku studentët janë regjistruar;
- të përdorin infrastrukturën e vënë në dispozicion nga Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, për realizimin e procesit mësimor;
- të përfitojnë nga shërbimet mbështetëse, që ofrohen nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë;
- të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes së Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin për arsimin e lartë.
- të shprehin vlerësimet e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit të Universitetit;
- të përfitojnë bursë studimi kur plotësojnë kushtet e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave si dhe shpërblime të veçanta që administrohen nga universiteti;
- të sigurohen nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, në një ndër shoqëritë e sigurimit, për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar të studimeve për riskun e ndërprerjes së veprimtarisë apo risqe të tjera, sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimet e Ministrit përgjegjës të arsimit të lartë dhe Ministrit të Financave;
- të organizohen në këshillat e studentëve nëpërmjet të cilave bëhet përfaqësimi i tyre në organet drejtuese të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

- i) të ndjekin një program të dytë studimesh brenda të njëjtit cikël, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë statut.

Detyrimet e studentëve janë:

- a) të zbatojnë rregullat e përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë;
- b) të respektojnë Kodin e Etikës së Universitetit;
- c) të respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë;
- d) të frekuentojnë programet e studimit sipas parashikimeve të bëra në *syllabus*-et e lëndëve si dhe kriterëve të përcaktuara në Rregulloren e Universitetit;
- e) të paguajnë tarifat e përcaktuara për ndjekjen e programeve të studimit, si dhe tarifat e shërbimeve të ofruara nga universiteti, brenda afateve kohore të përcaktuara në Rregulloren e tij.

Studentit përsëritës, përgjithësisht i ndërpritet mbështetja nga fondet publike.

Neni 18

Shkeljet e rregullave të fakultetit

Shkelje të rregullave të Fakultetit të Shkencave Humane konsiderohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e studentit që çenojnë personalitetin e mësimdhënies dhe të çdo punonjësi tjetër të institucionit, normat etiko – morale të shoqërisë si kopjimi në provime, falsifikimi i dokumentave të ndryshme, aktet e rrugaçërisë, të vjedhjes etj, kur këto veprime nuk bartin elementë të veprës penale. Ndaj studentit që kryen këto veprime, merren masat disiplinore në përputhje me Rregulloren e Universitetit të Vlorës.

Neni 19

Shkeljet e integritetit akademik nga stafi akademik dhe studentët

1. Të gjithë anëtarët e stafit akademik në Departamentin e Drejtësisë duhet të praktikojnë dhe të ruajnë standardet e integritetit akademik dhe ndershmërisë. Integritet akademik do të thotë të paraqesësh vetveten dhe punën tënde me ndershmëri.
2. Mashtrimi në provime. Këtu përfshihen përdorimi i materialeve si libra dhe/ose shënime atëherë kur një gjë e tillë nuk është e autorizuar nga pedagogu, të kopjosh nga testimi apo detyra e dikujt tjetër, të ndihmosh dikë tjetër të kopjojë punën, të zëvendësosh punën e dikujt tjetër me punën tënde, të vjedhësh kopje të provimeve, ose të tjera forma shkeljesh në sjelljet gjatë provimeve.
3. Plagjiatura. Plagjiaturë do të thotë të përdorësh punën ose idetë e dikujt tjetër pa i dhënë atij personi kredite për punën e vet. Plagjiatura mund të shfaqet në forma të ndryshme dhe të gjitha format përbëjnë shkelje të të drejtave të autorësisë.
4. Falsifikimi i dokumentave apo paraqitja dizinformuese e kredencialeve të një personi është shkelje.
5. Bashkëpunimi i paautorizuar në detyra kompjuterike, hyrja e paautorizuar dhe përdorimi i programeve kompjuterikë duke përfshirë modifikimin e skedarëve kompjuterikë të krijuar nga të tjerë dhe ta paraqesësh atë punë, si punën tënde është shkelje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Neni 20

Informimi i studentëve

1. Informimi i studentëve bëhet nëpërmjet sistemit të organizuar të informacionit që ka Universiteti i Vlorës, lidhur me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloren e brendshme të institucionit, rregulloren e studimeve, procedurat në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, etj.
2. Informacioni i nevojshëm publikohet në disa forma:
 - a. format letër, në formën e guidave, rregulloreve, fletëpalosjeve, procedurave, etj, të cilat gjenden në sekretari dhe u vihen në dispozicion studentëve.
 - b. në format elektronik në faqen zyrtare të Universitetit, i cili është i aksesueshëm nga të gjithë studentët.
 - c. të shpallura në mjediset e Fakultetit të Shkencave Humane.

Neni 21

Ndërprerja e studimeve, largimi

1. Studenti mund të ndërpresë studimet për një periudhë kohore të caktuar. Në këtë rast ai duhet të bëjë një kërkesë pranë sekretarisë, në të cilën të përcaktojë kohën e ndërprerjes së studimeve.
2. Me rifillimin e studimeve, studenti duhet të shlyejë detyrimet e reja që lindin për shkak të ndryshimit të planit dhe programeve mësimore të lëndëve.

Neni 22

Lëvizja e studentëve

1. Studentët mund të lëvizin në kuadrin e shkëmbimeve dhe të projekteve ndërkombëtare në përputhje me marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura nga institucioni. Nëpërmjet zbatimit të Marrëveshjes Erasmus Plus studentët përfitojnë të drejtën e zhvillimit të një semestri në vendin pritës duke respektuar kriteret e përcaktuara në marrëveshje si dhe në përputhje me njoftimet zyrtare të bëra në Universitetin e Vlorës.
2. Ata mund të kryejnë praktikën në institucione ndërkombëtare jashtë shtetit ose kurse studimi në një nga universitetet partnere. Kjo lëvizje nuk konsiderohet si ndërprerje e studimeve dhe rregullohet në bazë të rregullave të ekuivalentimit.

Neni 23

Kushtet për procedurat e modalitetet për transferimin e studentëve

Procedurat transferuese në Departamentin e Drejtësisë, Fakulteti i Shkencave Humane, përcaktohen në rregulloren e Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës. Procedurat transferuese përfundojnë përpara fillimit të semestrit.

Studentët e Departamentit të Drejtësisë të cilët duan të tranferohen në universitete të tjera të vendit, në të njëjtën degë dhe sistem, paraqesin kërkesën në sekretarinë e Departamentit të Drejtësisë për



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

tërheqjen e listës së notave. Pas përgjigjes së pranimit nga universiteti pritës, përcillet dokumentacioni i plotë i studentit; detyrimet e shlyera me notat përkatëse, dëftesa e shkollës së mesme, dokumentacioni i bursës, etj. Pas kryerjes së transferimit studenti humb statusin e studentit të UV.

Për studentët që duan të transferohen në FSHH, Komisioni i ekuivalentimit të moduleve dhe krediteve të programeve mësimore të FSHH, mbi bazën e dokumentacionit që dërgon universiteti përkatës, përcakton detyrimet që do të ketë studenti, nëse pranohet në atë degë, sipas planit mësimor në fuqi si dhe njohjen e shlyerjes së lëndëve me ekuivalencë.

Çdo student që diplomohet në programin Bachelor në Drejtësi, ofruar nga Departamenti i Drejtësisë, Fakulteti i Shkencave Humane të Universitetit të Vlorës duhet të ketë të paktën 180 kredite të marra në FSHH.

Neni 24

Koordinatori i studentëve dhe kompetencat e tij

Koordinatori për marrëdhëniet me studentin është anëtar i stafit akademik të njësisë bazë, i emëruar nga drejtuesi i njësisë bazë, për të koordinuar marrëdhëniet e departamentit me studentët.

Koordinatori kryen promovimin e programeve të studimit të ofruara nga njësi bazë. Informon, orienton dhe këshillon studentët për veprimtarinë mësimore, kërkimore-shkencore dhe aktivitete të tjera.

Koordinatori ofron këshillim për zhvillimin e karrierës në njësinë bazë.

Ai këshillon studentët për problematika të ndryshme dhe raporton problematikat e tyre në departament.

Neni 25

Koordinatori i programit

Koordinatori i programit të studimit Bachelor në Drejtësi emërohet dhe shkarkohet nga Përgjegjësi i Departamentit.

1. Koordinatori i programit të studimit Bachelor në Drejtësi, koordinon veprimtarinë në përmbushje të misionit dhe vizionit të programit të studimit.
2. Drejton punën për hartimin dhe ndryshimin e Rregullores së programit të studimit dhe përgatitjen e strategjisë së zhvillimit të programit.
3. Në konsultim me stafin akademik të programit të studimit propozon ndryshime mbi programet mësimore.
4. Realizon analizën vjetore të programit të studimit.

Neni 26

Kriteret për marrjen e diplomës

Modalitetet dhe procedurat për marrjen e diplomës parashikohen në rregulloren e diplomimit të Departamentit të Drejtësisë.





Adresa /Adress: L. Pavarësia,
Bulevardi Vlorë-Skelë

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al